

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6450  
E mërkurë, 27 tetor 2021  
çmimi 0.40 €

## Përfitimet e një baze amerikane në Kosovë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", DEMUSH SHASHA

# PA PËRKRAHJEN E BE-së DHE TË SHBA-SË VETINGU S'MUND TË ZBATOHET



Drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka thënë se përkrahja e Bashkimit Evropian (BE) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) është jetike për procesin e vetingut. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se pa përkrahjen e këtyre aleatëve ky proces nuk mund të zbatohet në Kosovë. Shasha ka theksuar se brengosja e BE-së për vetingun në drejtësi ka ardhur në mungesë të një dialogu në mes të institucioneve të Kosovës dhe BE-së. Sipas tij, ky proces kompleks kërkon ekspertizë specifike të cilën nuk e ka Kosova | FAQE 4-5

## SINDIKATAT DHE QYTETARËT, TË SHQETËSUAR ME RITJEN E ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE USHQIMORE

FAQE 8



## SPECIALJA I KËRKON POLICISË SË KOSOVËS GARANCI PËR LIRIMIN E PËRKOHSHËM TË HARADINAJT E TË GUCATIT

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## SPORT



## SONTE ZHVILLOHET DERBI MES YLLIT DHE TREPÇËS

F.10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## “Facebook”-u heq një video të presidentit brazilian për vaksinat

**BRASILIA, 26 TETOR** - Rrjeti sociale “Facebook” ka hequr një video, në të cilën presidenti i Brazilit, Jair Bolsonaro, ka folur për një lidhje të supozuar midis vaksinave kundër koronavirusit dhe sëmundjes së AIDS-it. Rrjeti social ka njoftuar se videoja i ka shkelur politikat e tij për vaksinat. “Politikat tona nuk

i lejojnë pretendimet se vaksinat kundër koronavirusit vrasin ose i dëmtojnë seriozisht njerëzit”, ka njoftuar “Facebook” në një deklaratë të cituar nga agjencia e lajmeve AP. Videoja u hoq edhe nga platforma e “Facebook”-ut dhe “Instagram”-it. “Facebook”-u, megjithatë, nuk iu përgjigj

pyetjes se përse kanë kaluar tri ditë përpara se përmbajtja të hiqej. Videoja thuhet se është postuar më 21 tetor, ndërsa është hequr më 24 tetor. Që nga fillimi i pandemisë, në mars të vitit të kaluar, Bolsonaro ka folur vazhdimisht kundër izolimit, maskave dhe vaksinimit.



## Katër fëmijë migrantë mbyten në brigjet e Greqisë

**ATHINË, 26 TETOR** - Ministri i Migracionit i Greqisë, Notis Mitarachi, ka njoftuar se katër fëmijë kanë vdekur pasi një gomone që transportonte migrantë nga brigjet e Turqisë, u fundos të martën pranë ishullit lindor grek Kios.

Mitarachi ka thënë se 22 persona janë nxjerrë të gjallë dhe se së paku një migrant është ende i zhdukur. “Me gjithë përpjekjet më të mira të rojës bregdetare, katër fëmijë, të gjithë nga mosha 3 deri në 14 vjeç konfirmohen të vdekur”, ka shkruar Mitarachi në një postim në “Twitter”.

Ai e akuzoi Turqinë për mosrespektim të një

marrëveshjeje të vitit 2016 me Bashkimin Evropian. “Autoritetet turke duhet të bëjnë më shumë për t’i parandaluar shfrytëzimet nga bandat kriminale. Këto udhëtime nuk duhet të lejohen kurrë të ndodhin”, ka thënë Mitarachi.

Turqia strehon numrin më të madh të refugjatëve në botë, rreth 4 milionë dhe thotë se BE-ja është e ngadalshme për përmbushjen e premtimeve për mbështetje financiare.

Migrantët dhe refugjatët që përpiqen të arrijnë në vendet e BE-së janë kryesisht të ikur nga luftërat dhe varfëria në Lindjen e Mesme dhe në Azinë Jugore.



## Australia zotohet se do t’i ulë emetimet e karbonit në zero



**CANBERRA, 26 TETOR** - Një nga ndotësit më të kritikuar në botë, Australia, premtoi se do t’i ulë në zero emetimet e karbonit deri në vitin 2050.

Zotimin e bëri kryeministri i këtij vendi, Scott Morrison. Ai tha se Australia ka plan për t’i zvogëluar emetimet, porse ai nuk përfshin mbylljen e sektorëve që përdorin lëndë djegëse fosile, e që shkaktojnë ndotje të mëdha. “Ne nuk do të marrim mësim nga të tjerët që nuk e kuptojnë Australinë. Mënyra australiane ka të bëjë me atë se si bëhet dhe jo a bëhet... Ka të bëjë me realizimin e saj”, tha Morrison. Për t’i ndaluar efektet e këqija të

ndryshimeve klimatike, vendet janë zotuar se do ta kufizojnë rritjen e temperaturave në 1.5 gradë celsius deri në vitin 2050.

Kjo kërkon uljen e emetimeve për 45 për qind deri në vitin 2030 dhe arrijtjen e vlerës zero deri në vitin 2050, thonë shkencëtarët.

Australia i ka zvarritur prej kohësh veprimet e saj klimatike, çfarë ka çuar në mosmarrëveshje midis saj dhe aleatëve strategjikë.

Australia është një nga vendet më të ndotura për kokë banori dhe furnizuese kryesore globale e qymyrit dhe gazit.

Morrison tha se më shumë se 20 miliardë dollarë australiane do të

investohen në “teknologjitë me emetime të ulëta” gjatë 20 vjetëve të ardhshëm. Ato përfshijnë përpjekjet për kapjen e karbonit në tokë, uljen e kostove të energjisë diellore dhe zhvillimin e industrive më të gjelbra.

Por, nuk ka asnjë plan për t’i kufizuar karburantet fosile. “Ne duam që industrinë tona të rënda, si minierat, të qëndrojnë të hapura, të mbeten konkurruese dhe të përshtaten, në mënyrë që ato të mbeten në funksion për aq kohë sa e lejon kërkesa globale”, tha Morrison. Ai tha se kjo do të ndihmojë ruajtjen e komuniteteve rurale.

## Pakistani dhe Kina bëjnë thirrje për ndihma në Afganistan

Kabul, 26 tetor - Udhëheqësit e Pakistanit dhe Kinës i bënë apel të përbashkët komunitetit ndërkombëtar për ndihmë urgjente humanitare dhe ekonomike në Afganistan. Kryeministri i Pakistanit, Imran Khan, dhe presidenti i Kinës, Xi Jinping, diskutuan për situatën në Afganistan gjatë një bisede telefonike.

Në deklaratën e lëshuar më pas, ata thanë se njerëzit atje

kanë nevojë për ndihmë ndërkombëtare, që “do t’ua lehtësonte vuajtjet” dhe “do ta parandalonte jostabilitetin”. Qeveritë perëndimore kanë ndërprerë fondet e ndihmave për Afganistanin prejse talebanët kanë marrë pushtetin në muajin gusht. Aktualisht sundimtarët talebanë nuk kanë qasje në rezervat prej 9 miliardë dollarësh të Bankës Qendrore afgane - shumica e të cilave

mbahen në ShBA.

Një ditë më herët Kombet e Bashkuara paralajmëruan se miliona afganë do të përballen me uri gjatë këtij dimri, nëse nuk ndërmerren veprime të menjëhershme për t’i ndihmuar ata.

Programi Botëror i Ushqimit i OKB-së tha se rreth 22.8 milionë afganë përballen me pasiguri ushqimore. Shifra nënkupton më shumë se gjysmën e popullsisë afgane.



# Sindikatat dhe qytetarët, të shqetësuar me rritjen e çmimeve të prodhimeve ushqimore a

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 TETOR - Në Kosovë muajt e fundit janë shtrenjtuar dukshëm çmimet e prodhimeve bazë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rritja e çmimeve ka filluar nga muaji prill me 1.2 për qind, duke arritur në 4.9 për qind në muajin shtator. Lëvizje më të mëdha të çmimeve kanë pasur: buka, vaji, sheqeri, mielli dhe pemët e perimet.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) përmes një komunikate për media ka reaguar rreth rritjes së çmimeve të prodhimeve ushqimore ditët e fundit në Kosovë.

BSPK-ja, e cila drejtohet nga At dhe Hykolli, ka theksuar se është duke e ndjekur me shqetësim rritjen e çmimeve të artikujve esenciale në Kosovë. Kjo situatë, sipas BSPK-së, e rëndon edhe më tepër gjendjen sociale të punëtorëve dhe të qytetarëve në vend.

“Fatkeqësisht, edhe pse ka rritje të vazhdueshme të çmimeve edhe për artikujt esenciale siç janë mielli, vaji sheqeri etj., nuk kemi rritje pagash për punëtorët si dhe paga minimale në vend vazhdon të mbetet e njëjtë. Si kryetar i BSPK-së, njëkohësisht si kryesues i Këshillit Ekonomik-Social, e ftoj publikisht qeverinë që t’i bashkohet Këshillit Ekonomik-Social dhe të iniciohet rritja e pagës minimale në vend. Është e rëndësishme që kjo të bëhet sa më parë në mënyra që të përfshihet në buxhetin e vitit të ardhshëm. Njëkohësisht ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës, pa dallim, që ta përkrahin rritjen e pagës minimale në vend”, thuhet në reagimin e BSPK-së, duke theksuar se mbesin të përkushtuar të bashkëpunojnë me qeverinë dhe secilin institucion që mbështet kauzën e drejtë sociale për rritjen e pagës minimale në vend.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Republikës së Kosovës (SBASHK) ka theksuar të martën se ngritja e



çmimeve po shton pakënaqësitë dhe ka kërkuar nga qeveria të veprojë, ndërkohë që ka rikujtuar që rritja e fundit e pagave ka ndodhur në mënyrë simbolike prej 4-përqindësh nga qeveria Haradinaj në vitin 2018.

SBASHK-u thekson se ngritjen e çmimeve e kanë përjetuar në buxhet familjarët dhe punëtorët e arsimit dhe të punësuarit e tjerë, por me keq se këta, këtë të vërtetë e kanë përjetuar ata me ndihmë sociale apo edhe të papunët, që në Kosovë nuk janë të paktë.

## Rritja e çmimeve, Kurti paralajmëron ndihmë për qytetarët

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se qeveria që udhëheq ai nuk mund të fajësohet për ngritjen e çmimeve në treg pasi kjo, sipas tij, ka ndodhur si pasojë e disa faktorëve. Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës po punon që, në ditët në vijim, të dalë me një

pako masash që u vijnë në ndihmë qytetarëve.

Në një koment publikuar në llogarinë e vet në “Facebook”, Kurti ka përmendur shkëputjen e zinxhirit të furnizimeve për shkak të pandemisë dhe rritjen globale të çmimit të energjisë si disa nga arsyet e inflacionit.

Shkalla e inflacionit, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në fund të muajit shtator ishte 4.9 për qind. “Ditët e fundit jemi dëshmitarë të një fushate e cila trumbeton çdo ditë për rritje çmimesh dhe tenton të fajësojë qeverinë për këtë”, ka thënë Kurti, duke mos specifikuar se për kë e ka fjalën. Sipas tij, “një gjë të tillë kishin tentuar ta bënin edhe në fillim të pandemisë Covid-19 vitin e kaluar, me çmimin e miellit”. “Shumë qytetarë kishin përfunduar me sasi mielli nëpër shtëpitë e tyre, të blera me çmim dy e trefish [më të lartë] nga frika e mungesës së miellit dhe rritjes së çmimit. Fituesit e vetëm atëherë dolën të ishin tregtarët”, ka thënë Kurti.

# FSK-ja vazhdon stërvitjet dhe garat ushtarake bashkë me vendet anëtare të NATO-s



PRISHTINË, 26 TETOR - Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) po merr pjesë në stërvitjen qendrore të Forcave të Armatosura Slovene për vitin 2021, “Disaster Relief and Military Mobility Exercise 2021” (DRM2 EX21), duke iu

bashkangjitur kështu kolegëve të tyre të forcave slovene dhe 19 forcave të shteteve të tjera të BE-së dhe NATO-s.

Kjo stërvitje synon ta forcojë gatishmërinë e Forcave të Armatosura slovene në sistemin e mbrojtjes nga fatkeqësitë

natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Republikën e Sllovenisë. Gjithashtu, kjo stërvitje synon t’i integrojë edhe mekanizmat e sigurisë slovene me shtetet anëtare të BE-së dhe forcat e tjera partnere si vendi ynë, të rëndësishme në fushën e

mobilitetit ushtarak dhe mbështetjes logjistike. Në po të njëjtën kohë, një njësi tjetër e FSK-së, me ftesë të ushtrisë slovene, merr pjesë në Garën Ushtarake Ndërkombëtare “Skuadra më e mirë 2021”.

Në këtë garë konfirmohen shkathtësitë e pjesëtarëve të FSK-së dhe promovohet bashkëpunimi ndërkombëtar i korpusit të nënoficerëve tanë në ndërveprim me kolegët slovenë dhe kolegët e tjerë nga vendet anëtare dhe partnere të NATO-s.



FLET PËR "EPOKËN E RE", DEMUSH SHASHA

## Pa përkrahjen e BE-së dhe të ShBA-së vetingu s'mund të zbatohet

Drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka thënë se përkrahja e Bashkimit Evropian (BE) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) është jetike për procesin e vetingu. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se pa përkrahjen e këtyre aleatëve ky proces nuk mund të zbatohet në Kosovë. Shasha ka theksuar se brengosja e BE-së për vetingun në drejtësi ka ardhur në mungesë të një dialogu në mes të institucioneve të Kosovës dhe BE-së. Sipas tij, ky proces kompleks kërkon ekspertizë specifike të cilën nuk e ka Kosova

**EPOKA E RE****Muhamet KOÇI**

**PRISHTINË, 26 TETOR** - Drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka folur për shqetësimet e Bashkimit Evropian për procesin e vetingu në fushën e drejtësisë. Ai ka thënë se ky proces nuk do të mund të zbatohet pa përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Shasha ka deklaruar se realizimi i këtij procesi kërkon ekspertizë specifike e cila nuk ekziston në Kosovë. "Konsideroj se pa përkrahjen e BE-së dhe të ShBA-

së vetingu nuk do të jetë i mundur të zbatohet pasi që një proces kaq i ndjeshëm dhe kompleks kërkon jo vetëm përkrahje politike nga aleatët tanë strategjikë, por edhe ekspertizë specifike e cila nuk ekziston në Kosovë", ka thënë Shasha.

Ai ka treguar se pse ka ardhur deri te kjo brengosje e BE-së për procesin e vetingu të propozuar nga Qeveria e Kosovës. Sipas Shashës, kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së dialogut në mes të institucioneve të Kosovës dhe BE-së. "Nga ana tjetër, unë jam i bindur se mungesa e harmonisë së qëndrimeve në mes të institucioneve të Kosovës dhe

BE-së sa i përket vetingut vjen si rezultat i mungesës së dialogut thelbësor në mes të dy palëve. Rrjedhimisht, jam i bindur se nëse qeveria arrin të shpjegojë në mënyrë koherente dhe logjike nevojën dhe mënyrën e zbatimit të vetingut në Kosovë, atëherë do ta sigurojë edhe përkrahjen e BE-së dhe të ShBA-së", ka thënë Shasha.

Në këtë intervistë drejtori i Institutit EPIK-ut ka folur edhe për kundërshtimin që presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ia ka bërë qëndrimit të BE-së për procesin e vetingu. "Jam plotësisht dakord që Kosova është në të drejtën e saj dhe të ketë qëndrime shtetërore të cilat reflektojnë vullnetin e

qytetarëve. Sidoqoftë, do të pëlqejë që mospajtimet eventuale me aleatët tanë strategjikë të trajtohen mbrapa dyerve të mbyllura dhe jo përmes diskursit publik", ka thënë Shasha.

**"Epoka e re":** *Presidentja e vendit ka shprehur mospajtime me raportin e BE-së për këtë çështje. Si e keni parë reagimin e saj? A është kjo qasja që duhet ta ndjekin institucionet e Kosovës në raport me BE-në?*

**Shasha:** Jam plotësisht dakord që Kosova është në të drejtën e saj, se duhet të ketë qëndrime shtetërore të cilat reflektojnë vullnetin e qytetarëve. Sidoqoftë, do të pëlqejë që mospajtimet eventuale me aleatët tanë strategjikë të trajtohen mbrapa dyerve të mbyllura dhe jo përmes diskursit publik.

**"Epoka e re":** *Z. Shasha, si e keni parë raportin e progresit të KE-së për Kosovën?*

**Shasha:** Në përgjithësi, raporti konfirmon se nuk ka pasur

progres në reformat në rrugën tonë integruese, pasi që Kosova ka kaluar nëpër një periudhë kaotike politike ku kemi pasur dy qeveri të ndryshme brenda një periudhe të shkurtër kohore në mes të pandemisë. Një mjedis i tillë politik nuk ka lejuar progres të ndjeshëm në rrugën tonë integruese.

**"Epoka e re":** *Cilat janë porositë kryesore që institucionet e Kosovës duhet t'i marrin nga ky raport?*

**Shasha:** Janë, ndoshta, dy mesazhe kryesore: dialogu me Serbinë dhe sundimi i ligjit. E para, raporti qartë nënvizon se dialogu me Serbinë është kyç për avancimin e rrugës sonë integruese. E dyta, sundimi i ligjit është kriteri i dytë më i rëndësishëm për avancimin e Kosovës në rrugën integruese, qoftë sa i përket liberalizimit të vizave apo marrjes së statusit të vendit kandidat.

**"Epoka e re":** *Në raport BE-ja shpreh shqetësimin e saj në*

# Përfitimet e një baze amerikane në Kosovë

PRISHTINË, 26 TETOR - Një bazë e përhershme ushtarake e Shteteve të Bashkuara (SHBA) në Kosovë do ta rriste sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, vlerësojnë njohësit e çështjeve të sigurisë dhe ish-ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha.

Qeveria e Kosovës më 15 tetor njoftoi se ua ka ofruar mundësinë Shteteve të Bashkuara që të krijojnë një bazë të përhershme ushtarake në Kosovë.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, ka thënë se këtë ofertë ia ka paraqitur nënkretarit të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, Colin Kahl, gjatë një vizite në Uashington. Sipas ministrit Mehaj, ShBA-ja është duke e shqyrtuar ofertën që pastaj të koordinohen lidhur me këtë çështje.

"Radio Evropa e Lirë" ka kërkuar më shumë hollësi rreth kësaj oferte që Kosova i ka bërë ShBA-së, por Ministria e Mbrojtjes nuk u është përgjigjur pyetjeve.

Lidhur me këtë ofertë nuk janë përgjigjur as zyrtarët e Departamentit Amerikan të Mbrojtjes.

## Berisha: Baza e përhershme ushtarake shuan pretendimet territoriale

Ish-ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se një bazë e përhershme ushtarake flet shumë për avancimin e raporteve të Kosovës me ShBA-në dhe zgjidhjen e sfidave të shumta që janë në Ballkanin Perëndimor. "Mundësinë për krijimin e një baze të përhershme ushtarake amerikane në Kosovë e shoh si një hap të qëlluar dhe e vlerësoj lart, pasi që kjo ndikon në rritjen e stabilitetit të brendshëm në Kosovë dhe në rajon në përgjithësi. Kjo, gjithashtu, do të ndikojë në avancimin e raporteve të Kosovës me ShBA-në", thotë Berisha.

Në Kosovë që nga viti 1999 ekziston kampi ushtarak amerikan Bondsteel. Ai gjendet në Ferizaj, rreth 40 kilometra nga Prishtina. Ky është kampi ushtarak amerikan i vetëm në Evropën Juglindore. Sipas agjencisë "Reuters", në këtë kamp qëndrojnë 700 ushtarë amerikanë.

Dallimi mes këtij kampi dhe një baze të përhershme ushtarake

amerikane, sipas ish-ministrit Berisha, është se baza e përhershme ka një porosi më të qartë për ata "që pretendojnë të marrin territore që nuk u takojnë". "Një bazë e përhershme ushtarake e ShBA-së në Kosovë do t'i shuante aspiratat e atyre që kanë pretendime territoriale ndaj Kosovës si dhe do të hapte rrugë për marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë", shton Berisha.

Ai shton se përmes kësaj baze ushtarake amerikane do të avancohet bashkëpunimi ushtarak në fushën e sigurisë mes dy vendeve si dhe do të ndihmohet zhvillimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). FSK-ja është aktualisht duke kaluar procesin e transformimit në Ushtrinë e Kosovës.

Vendosja e një pranie të përhershme ushtarake në Evropën Juglindore ishte kërkuar qysh në vitin 2017 nga Këshilli Atlantik me seli në Uashington, përmes një raporti mbi strategjinë e re amerikane në Ballkan. Në këtë raport thuhet se vendosja e një baze ushtarake amerikane në Evropën Juglindore do t'i ndihmonte stabilizimit të rajonit, kurse kampi Bondsteel do të ishte ideal për këtë qëllim.

Në atë raport thuhet se një veprim i tillë do të demonstronte një angazhim të vazhdueshëm të Shteteve të Bashkuara ndaj sigurisë në rajon dhe do ta forconte aftësinë afatgjatë të Shteteve të Bashkuara për të ndikuar mbi zhvillimet. "Trupat do ta ndihmonin forcimin e mundësive të autoriteteve vendase për ta parandaluar terrorizmin nëpërmjet stërvitjeve dhe shkëmbimit të praktikave më të mira dhe do të ofronin ndihmë në rast të katastrofave humanitare", thuhet në atë raport.

Vendosja e një pranie të përhershme ushtarake në Evropën Juglindore thuhet se do të dërgonte, po ashtu, një mesazh të qartë në rajon se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për ta penguar ndryshimin e kufijve ekzistuese.

## Islami: Baza ushtarake amerikane parandalon ndikimin rus

Profesori i shkencave të sigurisë, Avni Islami, thotë për Radion Evropa e Lirë se një bazë e përhershme ushtarake e ShBA-së në Kosovë do ta parandalonte

ndikimin rus në rajon. "Kosova ende konsiderohet vend që po përfshihet nga tensionet, siç ishin këto të fundit në veri të vendit që i krijoi Qeveria e Serbisë. Një bazë e përhershme ushtarake e ShBA-së në Kosovë do ta rriste sigurinë jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon", thotë Islami. Sipas tij, baza ushtarake e përhershme e ShBA-së do të duhej të vendosej në Mitrovicë të Veriut aty ku, siç thotë ai, po krijohen tensione.

Oferta e Qeverisë së Kosovës për ShBA-në për një bazë të përhershme ushtarake erdhi pas tensioneve që u krijuan në pikat kufitare me Serbinë, kur Qeveria e Kosovës, më 20 shtator, filloi zbatimin e reciprocitetit për targa me Serbinë.

Si rezultat i këtij vendimi, në vendkalime kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak në veri të Kosovës serbët lokalë patën bllokuar rrugët me automjete të rënda si formë e kundërshtimit të vendimit të qeverisë. Kosova dhe Serbia arritën pajtimin mbi targa më 30 shtator. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vendosur marrëdhënie diplomatike me Kosovën në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë nga Serbia.



lidhje me procesin e vetingut në drejtësi. Pse mendoni se BE-ja po e kundërshton këtë proces?

**Shasha:** Qëndrimi i BE-së është se vetingun duhet parë si mjet i fundit në adresimin e sfidave të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Konsideroj se BE-ja është e mendimit se para nisjes së një procesi kaq të ndjeshëm dhe kaq kompleks sikur që është vetingu, duhet eksploruar të gjitha rrugët e tjera që i kemi për momentin në dispozicion. Pra,

me fjalë të tjera, qëndrimi i BE-së është se fillimisht duhet shfrytëzuar në plotni legjislacioni dhe instrumentet momentale për avancimin e sundimit të ligjit, e vetëm nëse ato dështojnë mund të kalohet te zbatimi i vetingut.

**"Epoka e re":** Pas brengosjes së BE-së ndaj këtij procesi, a duhet të vazhdojë procesi i vetingut?

**Shasha:** Konsideroj se pa përkrahjen e BE-së dhe të ShBA-

së vetingu nuk do të jetë i mundur të zbatohet pasi që një proces kaq i ndjeshëm dhe kompleks kërkon jo vetëm përkrahje politike nga aleatët tanë strategjikë, por edhe ekspertizë specifike e cila nuk ekziston në Kosovë. Nga ana tjetër, unë jam i bindur se mungesa e harmonisë së qëndrimeve në mes të institucioneve të Kosovës dhe BE-së sa i përket vetingut vjen si rezultat i mungesës së dialogut

thelbësor në mes të dy palëve. Rrjedhimisht, jam i bindur se nëse qeveria arrin të shpjegojë në mënyrë koherente dhe logjike nevojën dhe mënyrën e zbatimit të vetingut në Kosovë, atëherë do ta sigurojë edhe përkrahjen e BE-së dhe të ShBA-së.

**"Epoka e re":** Presidentja e vendit ka shprehur mospajtime me raportin e BE-së për këtë çështje. Si e keni parë reagimin

e saj? A është kjo qasja që duhet ta ndjekin institucionet e Kosovës në raport me BE-në?

**Shasha:** Jam plotësisht dakord që Kosova është në të drejtën e saj, se duhet të ketë qëndrime shtetërore të cilat reflektojnë vullnetin e qytetarëve. Sidoqoftë, do të pëlqejja që mospajtimet eventuale me aleatët tanë strategjikë të trajtohen mbrapa deryve të mbyllura dhe jo përmes diskutit publik.

## Kosova regjistron edhe 20 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 26 TETOR - Ministria e Shëndetësisë në Kosovë ka njoftuar se të martën janë regjistruar 20 raste me Covid-19, pas testimit të 2 072 mostrave. Në 24 orët e fundit nuk është regjistruar asnjë viktimë. Autoritetet shëndetësore kanë thënë se më 26 tetor, 31 persona

janë shëruar derisa 427 persona janë ende aktivë në koronavirus. Prej shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar mbi 160 000 raste të infektimit. Prej këtyre 2 975 persona kanë vdekur. Prej nisjes

së fushatës së vaksinimit 707 296 persona janë vaksinuar plotësisht kundër këtij virusi derisa 835 679 persona kanë marrë dozën e parë. Deri më 26 tetor në orën 15:00 është vaksinuar plotësisht 39.3 për qind e popullsisë së përgjithshme.



## Lumezi kërkon rishqyrtimin e rastit të dhunimit të një të miture në Pejë

PRISHTINË, 26 TETOR - Kryeprokurori i Shtetit në Kosovë, Aleksandër Lumezi, ka kërkuar të martën nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, Agim Kurmehej, që ta rishqyrtojë rastin e përdhunimit të një të miture. Mediat në Kosovë kanë raportuar të hënën, më 25 tetor, se Gjykata Themelore në Pejë e ka dënuar të dyshuarin për përdhunim me tetë muaj e tetë ditë burgim. Mirëpo me vendimin e Lumezit, rasti i prokurores Lirije Morina do të

rishqyrtohet, si dhe është kërkuar që të merren të gjitha veprimet e nevojshme për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sipas të dhënave nga kryeprokuroria e shtetit, për nëntë muaj të vitit 2021, në Kosovë janë regjistruar 1 548 raste të dhunës, prej të cilave 1 396 janë regjistruara si dhunë në familje. Autoritetet në Kosovë kanë shqiptuar gjopa të ndryshme për dhunë në familje, përfshirë burgimin me kusht, me gjobë, apo dënime efektive.



## Shërbimi Korrektues lehtëson masat për vizita familjare



**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 TETOR - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK), në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, bazuar në vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të pandemisë në vend, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të të burgosurve dhe stafit, nga data 28 tetor 2021, me urdhër operativ ka ndërmarrë masa lehtësuese. "Lejohen dy të rritur dhe dy fëmijë për të vizituar një të burgosur; vizitat familjare të mbahen në distance dhe me mjete mbrojtëse, maska të jetë e vendosur gjatë gjithë kohës; vizita në institucione të hapura pa barriera, të bëhet me mjete

mbrojtëse, maska dhe të respektohet distanca; secili vizitor, para se të hyjë në institucion, duhet të dëshmojë certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një doze të vaksinës kundër Covid-19; testi RT-PCR negativ për Covid-19, jo më i vjetër se 72 orë dhe testi i shpejtë antigen negativ jo më i vjetër se 48 orë", ka njoftuar ShKK-ja. Për fëmijët nën moshën 16 vjeç nuk kërkohet testi. Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se do ta vazhdojë bashkërendimin institucional me institucionet relevante të Republikës së Kosovës dhe do ta mbajë të informuar opinionin publik rreth hapave në vazhdim.

## Ministri Mehaj udhëton sërish për në ShBA

Prishtinë, 26 tetor - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka udhëtuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me ftesë zyrtare nga Asociacioni Ndërkombëtar i Operacioneve të Stabilitetit (ISOA) me seli në Uashington. Me këtë rast, ministri Mehaj do të marrë pjesë në samitin e pesëmbëdhjetë vjetor të ISOA-s, në mesin e mbi 300 personaliteteve zyrtare nga e mbarë bota, ministra e shefa të mbrojtjes, diplomatë, përfaqësues të agjencive shtetërore të industrisë së mbrojtjes nga ShBA dhe vende

partnere të saj. Gjatë kësaj vizite ai do të ketë përsëri takime me autoritete të rëndësishme zyrtare amerikane dhe autoritete të industrisë së mbrojtjes. Samiti i këtij viti, ndër të tjera, do të ketë sesione me temat për sigurinë kibernetike: Reforma të prokurimit të mbrojtjes; Gratë, paqja dhe siguria; Pandemitë dhe siguria ndërkombëtare shëndetësore etj. ku do të paraqiten ambasadorë, autoritete të larta nga Departamenti i mbrojtjes, Departamenti i Shtetit, senatorë, kongresmenë etj.



## Specialja i kërkon Policisë së Kosovës garanci për lirimin e përkohshëm të Haradinajt e të Gucatit

HAGË, 26 TETOR - Trupi gjyqësor II ka urdhëruar Policinë e Kosovës që deri më 26 nëntor 2021 të ofrojë informacion lidhur me autorizimet dhe kapacitetet e saj lidhur me lirimin e mundshëm të përkohshëm të ish-udhëheqësve të OVLUÇK-së, Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. "Policia e Kosovës të ofrojë informacion lidhur me lirimin e mundshëm të përkohshëm të Gucatit dhe

Haradinajt. Trupi gjyqësor II urdhëroi Policinë e Kosovës që deri më 26 nëntor 2021 të ofrojë informacion, ndër të tjera, lidhur me autorizimet dhe kapacitetet e saj lidhur me lirimin e mundshëm të përkohshëm të Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt", thuhet në njoftimin e publikuar në faqen e Dhomave të Specializuara.

Në Gjykatën Speciale të martën

ka vazhduar gjykimi ndaj Gucatit e Haradinajt. Ata akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, frikësim të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Ata janë arrestuar më 25 shtator të vitit 2020.



## Kurti takon përfaqësuesit e ECFR-it, shprehet brenga për vonesën e vizave për Kosovën

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të martën në takim delegacionin e Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë (ECFR), i prirë nga Vessela Tcherneva, zëvendës drejtoreshë dhe shefe e zyrës së ECFR-së në Sofje. Kryeministri Kurti ka theksuar përkushtimin e qeverisë për luftimin e korrupsionit dhe krimin dhe krijimin e vendeve të punës në mënyrë që të ofrojmë mundësi të barabarta për të gjithë. Ai ka veçuar synimet për krijimin e një ambienti të favorshëm për t'i tërhequr investitorët e huaj drejt krijimit të një ekonomie të qëndrueshme dhe zhvillimit të vendit.

Kryeministri Kurti ka theksuar se zgjedhjet demokratike dhe fitorja bazuar në përkrahjen masive e qytetarëve kanë sjellë rezultate pozitive në të gjitha fushat. Ai vuri theksin te rritja e hovshme e ekonomisë që, sipas Bankës Botërore, është 9,9 për qind. "Për shkak të rritjes së besimit të qytetarëve në qeveri janë rritur edhe të hyrat buxhetore, investimet e jashtme si dhe remitancat nga diaspora. Të gjithë këta faktorë kanë



ndikuar në shëndetin dhe rritjen e ekonomisë", ka deklaruar Kurti. Delegacioni u interesua për zhvillimet e gjithëmbarshme në vend në këta shtatë muaj të qeverisjes, me theks në bashkëpunimin rajonal dhe bisedimet me Serbinë. Në fushën e bashkëpunimit

rajonat, Kosova është pro bashkëpunimit dhe integritetit në kuadër të agjendës evropiane dhe me praninë e pjesëmarrjes së BE-së. Kryeministri Kurti ka potencuar se bashkëpunimi duhet të jetë ekonomik, por edhe i bazuar në vlera ku avancojmë të drejtat dhe liritë. "Bisedimet me

Serbinë janë për statusin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku zgjidhen çështjet e pazgjidhura sikurse borxhet, dëmet e luftës e reparacionet, e që rezultojnë me njohje reciproke", është shprehur kryeministri Kurti. U bisedua edhe për procesin e

liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, për çka përfaqësuesit e ECFR-së shprehën brengën për vonesën në këtë proces. Delegacioni nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë shprehu mbështetje për punën dhe objektivat e qeverisë.

## Asociacioni i Komunave kërkon heqjen e orës policore

Prishtinë, 26 tetor - Drejtori i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka bërë me dije se ka një muaj që nga Ministria e Shëndetësisë kanë kërkuar heqjen e orës policore dhe përdorimin e maskës për personat që tashmë janë imunizuar kundër Covid-19.

Ibrahim ka thënë se këto kërkesa janë paraqitur në takim të fundit ushtrueses së detyrës së ministrit të Shëndetësisë, Dafina Gexha-

Bunjaku. "Në takimin e fundit që kemi pasur me ushtruesen e detyrës të ministrit të Shëndetësisë, Dafina Gexha-Bunjaku, kemi kërkuar që të hiqet ora policore dhe mbajtja e maskës në ambiente të hapura kur personi është vetëm dhe për ata që janë të imunizuar kundër koronavirusit. Është e palogjikshme që të ketë orë policore nga ora 00:00 kur gastronomia punon deri në

orën 23:00 e njësoj është edhe përdorimi i maskës kur një person ecën vetëm në rrugë", ka thënë Ibrahim.

Ai ka treguar se nga MSh-ja kanë kërkuar argumente shkencore për mbajtjen e orës policore teksa thotë se në rajon nuk kanë këtë kufizim. "Ne e kemi përpiluar një listë me shtetet ku nuk ka orë policore e as maskë në ambiente të jashtme, prandaj kërkojmë që kjo kërkesë të zbatohet", ka thënë Ibrahim.



# ZKA-ja identifikon shpenzime të panevojshme në shërbimet e transportit ajror

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Kontratat e centralizuara - shërbimet e transportit ajror". Ky auditim ka mbuluar periudhën 2016 - 2019 dhe ka pasur për qëllim që të vlerësojë nëse furnizimi me bileta për shërbimet e transportit ajror është kryer në përputhje me kontratat. Për këtë qëllim janë audituar një numër i konsiderueshëm i furnizimeve me bileta në institucione si në Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit dhe Infrastrukturës, komunën e Gjilanit, Gjakovës, Vushtrrisë dhe të Suharekës. "Procesi i auditimit ka evidentuar se disa nga organizatat buxhetore kishin bërë më shumë shpenzime sesa ishte parashikuar fillimisht për shkak të blerjes së numrit të madh të biletave të klasave më të larta se klasa ekonomike e udhëtimit e që ishin prej dy deri në gjashtë herë më të shtrenjta se biletat e klasës ekonomike. Rezultatet e këtij auditimi tregojnë se shpenzimet për udhëtime në klasa më të larta sesa klasa ekonomike përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve për shërbimet e transportit ajror", është thënë në njoftimin e ZKA-së. Bazuar në gjetjet e auditimit rezultojnë se tre faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e

vlerës së shpenzimeve për shërbimet e transportit ajror janë udhëtimet në biznes klasë, shtyrjet e udhëtimeve dhe anulimet e udhëtimeve. "Shuma e rimbursimit për biletat e anuluar ishte mesatarisht rreth 59 për qind e çmimit blerës. Kjo nënkupton se rreth 41 për qind e vlerës së biletave të anuluar janë shpenzime për bileta që nuk janë shfrytëzuar, gjë që ka kontribuar në rritjen e shpenzimeve të përgjithshme të kontratave për shërbime të transportit ajror duke i çuar në skadim të parakohshëm", është theksuar në njoftimin e këtij institucioni. Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, me rastin e publikimit të këtij raporti, ka deklaruar: "Rezultatet e këtij procesi të auditimit tregojnë se ka nevojë për përmirësime në procesin e furnizimit me shërbime të transportit ajror. Për t'i eliminuar mangësitë e identifikuar, duhet të ndërmerren veprime në nivel qeveritar, duke rishikuar Udhëzimin Administrativ, ku do të rregullohej përdorimi i klasave të tjera të udhëtimit në transport ajror", ka thënë Spanca. Me qëllim të përmirësimit të procesit të blerjes së shërbimeve të transportit ajror dhe shfrytëzimit më racional të buxhetit, Zyra Kombëtare e Auditimit ka rekomanduar Qeverinë e Kosovës që ta rishikojë Udhëzimin Administrativ nr. 2004/07 për ta adresuar çështjen e klasave të



lejuara të udhëtimit në transport ajror, duke specifikuar qartë rastet dhe funksionet që bëjnë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm. Agjencia Qendrore e Prokurimit si përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe monitorim të kontratave ka

rekomanduar që të bëjë një planifikim më të mirë të aktivitetit të prokurimit (bazuar në analizën e kontratave aktuale dhe paraprake) në mënyrë që të parashikojë më saktë çmimin e tarifës së shërbimit për biletë. Po ashtu, ka rekomanduar organizatat

buxhetore si shfrytëzuese të këtyre shërbimeve që ta përdorin klasën ekonomike për t'i shmangur shpenzimet e larta të transportit ajror, si dhe t'i planifikojnë udhëtimet më mirë në mënyrë që ta shmangin nevojën për anulime dhe shtyrje të udhëtimeve.

## Nënshkruhet marrëveshje 47-milionëshe për reformën në ndihmat sociale


**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 TETOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe drejtori i Bankës Botërore për Kosovë, Massimiliano Paolucci, kanë nënshkruar të martën marrëveshjen e financimit për "Projektin e reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë". Ministri Murati e ka vlerësuar lart mbështetjen e Bankës Botërore në procesin e reformës sociale në Kosovë dhe ka theksuar se kjo marrëveshje ka një vlerë të lartë për Republikën e Kosovës duke marrë parasysh nevojën e përmirësimit të targetimit të politikave sociale drejt familjeve më në nevojë. "Plani i Qeverisë së Kosovës u jep rëndësi të madhe programeve sociale të cilat sigurojnë që të minimizohet varfëria dhe të zgëzohet pabarazia ekonomike në vend. Andaj,

marrëveshja e nënshkruar sot siguron që targetimi i këtyre politikave të bëhet në mënyrë më të mirë të mundshme dhe angazhimi i Bankës Botërore drejt këtij qëllimi është tejte i mirëseardhur", ka thënë Murati. Kjo marrëveshje arrin vlerën deri në 47 milionë euro, ku investimet për përforcimin e sistemeve të ofrimit të mbrojtjes sociale pritet të jenë rreth 5 milionë euro, ndërsa shuma prej më se 40 milionë eurove do të orientohet drejt përmirësimit të performancës së skemës së ndihmës sociale. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje shënon edhe zbatimin e masës 3.3 - Reformimi i skemës së asistencës sociale, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ka njoftuar se në linjë me programin qeverisës, mbetet e përkushtuar drejt dizajnit dhe avancimit të politikave që synojnë ngritjen e mirëqenies qytetare në vend.







## Gruaja që i ndryshoi qëndrimet kur u njoh me realitetin antishqiptar në Ballkan

**Nga: Daut DAUTI**

Edith Durham (1863-1944) erdhi në Ballkan e pajisur me ideologjinë liberale gladstoniane (sipas kryeministrit britanik William Ewart Gladstone, që mbështeste interesat e sllavëve të Ballkanit), e cila ishte anti-otomane dhe si e tillë pro e krishterë. Në librin e saj të parë, “Through the Land of the Serb” (Nëpër tokat e Serbisë) të botuar më 1904 – që është i harruar nga serbët e nga shqiptarët e që, në fakt, nuk duhet të harrohet – ajo e përshkruan situatën e atëhershme në Serbi. Ka qëndrim kritik, por simpatia e saj është në anën e Serbisë. Më vonë, kur u njoh me shqiptarët, nisi të simpatizonte për kauzën e tyre nacionale. Por, kjo ishte vetëm simpati meqë ende ishte në anën e serbëve dhe të malazezëve. Si anti-otomane besonte se kombet e Ballkanit duhet të çlirohen dhe të vendosin sundim demokratik – si në shumë vende evropiane. Me kalimin e kohës qëndrimi i saj ndryshon në mënyrë drastike. Në mëngjesin e 9 tetorit të vitit 1912, Durham si gazetare shkoi në Goricë. E pa Ushtrinë malazeze të gatshme

për luftë dhe e vrojtoi knjazin e tyre, Nikollën, kur dha urdhër që ta zbrazej topi i parë në drejtim të Shqipërisë. Me këtë filloi Lufta Ballkanike dhe Durham me gëzim u kthye në Cetinë për ta dhënë e para lajmin që u botua në dy gazetatat kryesore britanike dhe evropiane të asaj kohe (“The Manchester Guardian” dhe “The Chronicle”). Në një gazetë tjetër, “The Nation“, i shfaqti ndjenjat e saja politike: “Gladstone kishte të drejtë kur tha se turku duhet të shkojë me thes e me plaçka”. Këto ndjenja ishin në përputhje me liberalizmin gladstonian dhe me ideologjinë pansllave. Pa kaluar një javë, Durham e vizitoi Tuzin për t’ia uruar princit malazet fitoren. Me veturë zyrtare mbretërore u kthye në Cetinë. Në mbrëmje e vështroi përfundimin e asaj dite dhe në gazetën “The Daily Chronicle” në artikullin “How Tuzi fell” (Si ra Tuzi), ajo shkroi: “Hëna e hollë ndriçonte me butësi në qiell – tashti e vetmja hënë mbi tokë. Hëna, emblema turke është vënë përtokë, shpresojmë përgjithmonë”. Për ta ndihmuar luftën e Malit të Zi kundër otomanëve, Durham nisi të punonte si infermiere në Ushtrinë

malazeze. Me shërimin e ushtarëve të plagosur malazezë donte ta ndihmonte luftën e këtij vendi kundër otomanëve. Por, në spitalet ushtarake malazeze e vërejtji tmerrin. Të plagosurit e Ushtrisë otomane jo që nuk shëroheshin, por malazezët ua prisnin hundët, veshët, kokat dhe ua rripnin lëkurën për së gjalli apo për së vdekuri. As mjekët malazezë nuk e shihnin si problema këtë punë. Një ditë, një ushtar i plagosur malazet i kishte thënë se donte të shërohej sa më shpejt që të merrte pjesë në plaçkitjen e Shkodrës dhe në dhunimin e grave shqiptare. Një mjek malazet i kishte thënë se prerja në fyt e grave shqiptare dhe e fëmijëve në Shkodër, ishte diçka në rregull. Për këtë arsye Durham u ankua te Qeveria malazeze, e cila qeshi me këtë rast. Në këtë moment Durham vendosi ta braktiste punën e saj si infermiere. Nuk pranoi ta ndihmonte këtë mentalitet. Një ditë pa se si grupe të grave malazeze po ktheheshin të lumtura nga Kosova ku grave të gjalla e të vdekura shqiptare të Pejës ua kishin plaçkitur edhe rrobat e trupit. Një ditë tjetër një oficer serb i foli me mburrje për masakrat që kishte bërë në

Lumë. Masakrat kundër ushtarëve otomanë dhe popullsisë shqiptare nuk ndaleshin. Durham e vërejtji shpejt se kjo luftë nuk kishte të bëjë me çlirimin, por se ishte e orientuar në zhdukjen e shqiptarëve për t’ua marrë tokat. Kjo nuk ishte kauza që do ta mbështeste Durham. Por, besimi i saj në liberalizmin britanik dhe në pasllavizëm e kishin sjellë deri në këtë pikë. Nga ky moment vërejtji se kishte qenë në anën e gabuar dhe praktikisht e merr anën otomane dhe nisi t’i mbështesë shqiptarët pa asnjë rezervë. Ishte e qartë se kjo nuk ishte luftë, por shfrenim barbar për ta masakruar tjetrin që kishte kulturë, gjuhë dhe religjion tjetër, dhe se gjithçka ishte mbarësuar nga urretja e pakufishme. Njerëzit e mëdhenj e ndërrojnë mendimin kur e shohin realitetin. Papritmas, artikujt e Durhamit në shtypin britanik ndryshuan në tërësi për nga karakteri. Shkrimet e saja u bënë aq antisllave sa që sot gazetatat britanike nuk do t’i botonin shkrime të tilla. Në gazetën “The Nation” ajo shkroi: “Cari Ferdinand e ka treguar të vërtetën kur ka thënë se kjo

luftë është e Kryqit kundër Hënës. Nga kryqi ortodoks rrjedhë gjak i kuq i viktimave. Viktimat nuk janë të gjithë myslimanë. Fanatizmi ortodoks nuk i ka kursyer as romano-katolikët”. Më në fund Durham u distancua tërësisht edhe nga liberalizmi gladstonian i cili, sipas saj, ndihmoi në prodhimin e dhunës në Ballkan. Për këtë, në letrën që ia dërgoi mikut të saj Boyle, i cili ishte njëri nga udhëheqësit e Komitetit të Ballkanit, shkroi: “Çfarë mashtrimi. E tërë kjo gjë për ‘çlirimin e të krishterëve nga zgjedha turke’, të cilën në Angli e nisi Gladstone, ai fanatiku plak. Duke mos jetuar kurrë në këtë vend, ai nuk e dinte për çfarë po fliste”. Prandaj, Durham e merr anën e Austro-Hungarezëve që i kundërshtonte më parë. Nisi punën e pandalshme të saj për kauzën shqiptare dhe nuk u ndal në këtë deri në vdekje. Askush nuk i ka paraqitur më mirë se Durhami tendencat e pan-sllavizmit dhe rezultatet gjenocidale të kësaj ideologjie. Kontributi i saj për shqiptarët mbeti i papërsëritshëm. Durham ka qenë grua gjigante dhe mbetet heroina më e madhe te shqiptarët. /Telegrafi/

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT  
 PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
 'BUJQËSIA'  
 TEL: 045/82 82 82**

# Sonte zhvillohet derbi mes Yllit dhe Trepçës



**PRISHTINË, 26 TETOR** - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e tetë në ArtMotion Superligën e Kosovës në basketboll. Sfidë kryesore do të jetë ndërmjet kampionit Golden Eagle Yllit dhe Trepçës, që ka dëshmuar formë të lartë në këtë edicion. Ylli ka tri fitore dhe katër humbje në këtë edicion, kurse mitrovicasit pesë fitore dhe një humbje. 'Xehetarët' kanë mundur therandasit në Superkupën e Kosovës dhe në xhiron e parë 72:69, andaj pritet një sfidë interesante. Të mërkurën përballen Sigal Prishtina dhe RC Cola Drita. Prishtinasit

kanë tri fitore dhe tri humbje, ndërsa gjilanasit shtatë humbje në shtatë ndeshje, duke qenë skuadra e vetme në elitë që nuk ka shënuar fitore në këtë edicion. Të enjten përballen dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës, Bashkimi dhe Peja, takim që zhvillohet në Rahovec. Prizrenasit kanë katër fitore dhe tri humbje, ndërsa pejanët gjashtë fitore dhe një humbje, duke qenë lidere e Superligës. Sfidë ndërmjet Rahovecit dhe Prizrenit 16 nuk do të zhvillohet, pasi rezultati do të regjistrohet nga Liga Unike.

## SUPERLIGA - JAVA 8

**Rahoveci - Prizreni 16**  
 (Rezultati regjistrohet nga Liga Unike)

**Të mërkurën takohen:**  
 17:00 Sigal Prishtina - RC Cola Drita  
 19:00 Golden Eagle Ylli - Trepça

**Të enjten takohen:**  
 17:00 Bashkimi - Peja

## SHKURT

### Ambasadori gjerman: Pengimi i sportistëve të Kosovës është shembull i Ballkanit të

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se politizimi i sportit nuk është asnjëherë ide e mirë. Ai këtë e ka thënë pas pengimit nga Serbia që u është bërë boksierëve kosovarë për të marrë pjesë në Kampionatin Botëror. "Politizimi i sportit nuk është ide e mirë asnjëherë. Pengimi i boksierëve kosovarë për të marrë pjesë në kampionat shkon në drejtim të kundërt. Kjo, fatkeqësisht, është shembull i Ballkanit të mbyllur, jo të hapur. Ashtu sikurse e tha dje zëdhënësi i BE-së, 'pajtimi afatgjatë në mes të shoqërisë nis nga shkëmbimi intelektual, kulturor, sportiv dhe artistik. Këto shkëmbime janë të domosdoshme për të ndërtuar mirëkuptim të ndërsjellë", ka thënë Rohde.

### Ermal Krasniqi, "Ylli i javës" në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare BKT Kosova, vazhdojnë të japin çmimin "Ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. "Ylli i javës" për xhiron e 11-të në BKT Superligë është shpallur futbollisti Ermal Krasniqi i FC Ballkani. 23-vjeçari i portokallezinjve nga Suhareka ka dhënë një kontribut të madh në triumfin e skuadrës së tij ndaj kampionit në fuqi FC Prishtina, me një gol dhe një asistim. Për sulmuesin e Ballkanit, i cili po kalon formë të jashtëzakonshme, kjo është hera e dytë që shpallet "Ylli i javës" në këtë edicion, pasi këtë çmim e kishte fituar edhe në xhiron e dytë. Çmimin "Ylli i javës" për sulmuesin e Ballkanit e jep Fisnik Morina, menaxher i Degës së BKT-së në Fushë-Kosovë dhe Festa Hajdari, Retail Senior Specialiste në Degën e BKT-së në Gjilan.

### Rashica viziton Ambasadën e Kosovës në Britani të Madhe

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica, e ka vizituar sot Ambasadën e Kosovës në Britani të Madhe. Futbollisti nga Vushtrria luan në Premierligë te Norwich City. "Patëm nderin dhe kënaqësinë të mirëpresim sot në Ambasadë futbollistin dhe krenarinë e kombëtares sonë, Milot Rashica. E ngarkuara me punë, znj. Arrita Gjakova, i dëshiroi Milotit shumë suksese me paraqitjet e tij me Norwich City", thuhet në njoftimin e ambasadës. Në postim ata thanë që puna dhe sukseset e Rashicës janë frymëzim për të gjithë brezat e rinj.

# Muqolli: Kemi kohë të përgatitemi për ndeshjet me rumunët

**PEJË, 26 TETOR** - Trajneri i Besa Famgas, Arben Muqolli, ka komentuar shortin për raundin e tretë të Kupës Evropiane. Besa takohet me skuadrën e fuqishme nga Rumania, Potaissa Turda, që ka fituar Kupën Sfiduese në vitin 2018. Ndeshja e parë luhet në Pejë në fund të nëntorit. "Është kundërshtar jo i njohur mirë por, siç e dimë, hendbolli rumun është shumë i fortë. Rumunët kanë traditë në hendboll. Prej tash fillojmë ta studiojmë sa më mirë kundërshtarin. Kemi kohë të mjaftueshme që të përgatitemi për ndeshje", ka thënë Muqolli. Besa Famgas të dielën e mposhti Borcin dhe avancoi në raundin e tretë të Kupës Evropiane.



# Kumbulla, pas dënimit nga Mourinho: Nga gabimet përmirësohesh

Pak fjalë, por domethënëse. Pas kritikave të ashpra për paraqitjen ndaj Bodo Glimt në Norvegji dhe lënies në

tribunë për ndeshjen ndaj Napolit në fundjavë, mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Marash Kumbulla,

ka zgjedhur ta thyejë heshtjen nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale. "Nga gabimet

përmirësohesh", ka shkruar mbrojtësi i verdhekuqve në "Instagram". Kjo për t'i kujtuar trajnerit të tij, Jose

Mourinho, se është vetëm 21 vjeç dhe një gabim apo një ndeshje e luajtur keq, nuk janë kurrsesi fundi i botës.

## Zidane nuk është i interesuar për ofertën e Unitedit

MANCHESTER, 26 TETOR - Një kandidatë më pak për të zëvendësuar Ole Gunnar Solskjaer në stolin e Manchester Unitedit, nëse drejtuesit e "Djajve të Kuq" vendosin të shkarkojnë teknikun norvegjez. Zinedine Zidane, ish-trajneri i

Realit të Madridit dhe një ndër emrat më të pëlqyer të tifozëve të Unitedit për t'i dhënë drejtimin e skuadrës, nuk është aspak i tërhequr nga ideja për t'u ulur në stolin e "Djajve të Kuq" dhe, sipas raportimeve të mediave angleze, ka dalë nga

gara pasi nuk është i interesuar për ta marrë drejtimin e klubit anglez. Drejtuesit e Manchester Unitedit për momentin kanë vendosur ta vazhdojnë aventurën me Solskjaerin, por sfidat e radhës mund të vendosin fatet e norvegjezit,

ndërkohë që edhe Antonio Conte, një emër i pëlqyer për drejtuesit e klubit nga "Old Trafford", nuk kanë dëshirë që të marrë një skuadër në mes të sezonit dhe kandidatë për pasuesin e Solskjaerit në stolin e Unitedit sa vijnë e pakësohen.



## Chicago si në kohët e arta, fiton edhe Brooklynin dhe Bucksat

CHICAGO, 26 TETOR - Ekipi i Chicago Bullsit e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme sezonin 2021-2022 në NBA, me 4 fitore në 4 ndeshje të luajtura deri më tani. Bullsat fituan me rezultat 111-108 në fushën e Torontos, sfidë ku për miqtë u dalluan DeRozan me 26 pikë e LaVine me 22 pikë. Fitojnë edhe kampionët e Milwaukee Bucksit, që mundën 119-109 Indianan jashtë fushës. Giannis Antetokounmpo realizoi 30 pikë e 10 rebounde, duke qenë lider



në fushë. Nuk zhgënjën as Brooklyn Netsi që, falë 25 pikëve të Durantit e 21 të Millsit, mundi me rezultat 104-90 Washingtonin. Në Perëndim, spikat fitorja e ekipit të Clippersit, që mundi 116-86 Portlandin,

ndeshje ku diferencën e bëri stoli, nga ku erdhën 65 pikë. Zhgënjën skuadra e Denverit, që u mund në fushën e vet 99-87 nga Clevelandi (Love 22 pikë e Allen 21), ndërsa Miami mundi 107-90 Orlandon (Butler 36 pikë).

### REZULTATET

Charlotte - Boston	129-140
Indiana - Milwaukee	109-119
Atlanta - Detroit	122-104
Brooklyn - Washington	104-90
Miami - Orlando	107-90
Toronto - Chicago	108-111
Minnesota - New Orleans	98-107
Denver - Cleveland	87-99
Clippers - Portland	116-86

## Koemani: Pavarësisht prej humbjeve, ne jemi duke u përmirësuar

BARCELONË, 26 TETOR - Humbja në "El Clasico" ndaj Real Madridit ka lënë një shije të keqe te skuadra e Barcelonës. Ndeshjen e radhës katalanasit e kanë me Sayo Vallecana, ditën e nesërme në kuadër të javës së 11-të në La Liga. Përpara kësaj ndeshjeje trajneri Koeman është shprehur se ka besim të plotë te skuadra e tij dhe e gëzon fakti që ekipi po përmirësohet dita-ditës. "Ne jemi duke u përmirësuar. Nuk duhet të shikojmë një rezultat, megjithëse e kuptoj zhgënjimin e humbjes nga Madridi. Dua ta shijoj atmosferën që ishte në stadium, por pranoj se gjërat varen nga rezultatet", ka thënë Koeman. Gjithashtu, në konferencën para mediave 58-vjeçari u pyet nga gazetarët nëse Barcelona është në një kohë të vështirë për shkak të rezultateve të marra, kryesisht



ndaj skuadrave të mëdha në letër, tekniku holandez thekson se presioni te skuadrat e mëdha është gjithmonë i pranishëm. "A jeni në një kohë të vështirë? Varet nëse fiton apo jo, në skuadrat më të mëdha ka më shumë presion. Ancelotti ka qenë në shumë klube dhe ai e di atë në mënyrë të përkryer, ai di

ta mbajë atë dhe po, kemi folur për këtë dhe ai më inkurajoi. Nesër do të përballemi me Rayon, një rival që na i bëri gjërat të vështira sezonin e kaluar në Copa del Rey. Ne duhet të vazhdojmë në përputhje me ndeshjet e fundit në të cilat kemi bërë gjërat mirë", ka shtuar Koeman.

### SHKURT

#### Henry: Messi është i izoluar te PSG-ja

Ish-legjenda e Arsenalit, Thierry Henry, ka thënë se Leo Messi ende nuk ka mundur të përshtatet më së miri te skuadra e PSG-së. "Është i izoluar, e prek më pak topin. Nuk po them që është i trishtuar, por i izoluar. Unë dua ta shoh gjithmonë Messin në qendër të lojës, aty ku ai mund t'i japë ritëm manovrës. Duhet gjetur një zgjidhje që Messi, Mbappe dhe Neymar të luajnë bashkë. Por, mendoj se Messi nuk mund të bëjë diferencën duke luajtur në të djathtë të sulmit, pasi nga aty merr pjesë më pak në lojë. Messi nuk flet shumë, flet vetëm me topin. Për momentin është ekipi i Mbappes. Topi shkon më shumë tek ai", ka deklaruar Henry.

#### Hamiltoni, Verstappenit: Asgjë nuk ka përfunduar

Lewis Hamiltoni përmes një postimi në rrjetet sociale ka paralajmëruar rivalët e tij, se beteja për titullin kampion bote në Formula 1 nuk ka përfunduar ende. Ai u rendit i dyti në garën e fundit në Austin (Amerikë) dhe tashmë është 12 pikë pas Max Verstappenit me Red Bull, që triumfoi në këtë pistë. "Nuk ka përfunduar ende", ka qenë mesazhi i Hamiltonit në rrjetet sociale, duke mbajtur lart moralin në prag të sfidës së radhës, pas 10 ditësh në Meksikë. Deri në fund të sezonit janë ende edhe 5 gara, çka do të thotë se gjithçka është e mundur. Piloti britanik i Mercedesit është në kërkim të titullit të tetë kampion", ka thënë Hamiltoni.

#### Benzema: 'Topi i Artë' është një ëndërr e fëmijërisë sime

Sulmuesi i Francës dhe Real Madridit, Karim Benzema, e ka ripërsëritur edhe një herë se ëndërra e tij ka qenë që një ditë të fitojë "Topin e Artë". "Topi i Artë", siç e kam thënë edhe më parë, është një ëndërr e fëmijërisë sime. Për mua ka rëndësi që jam mes kandidatëve, në listën finale. Një tjetër ëndërr që kam pasur ishte të luaja me Realin dhe të fitoja Ligën e Kampioneve. Këto dy të fundit i kam përmbushur", ka thënë Benzema.

#### Bayerni, gati ta shes Comanin në janar

Bayern Munchen është i hapur ta shesë anësorin Kingsley Coman gjatë afatit kalimtar të dimrit në janar. Kampioni gjerman e ka nxjerrë në shitje anësorin francez Coman për shkak të mospajtimeve për marrëveshjen e re. Bayerni dëshiron t'ia vazhdojë marrëveshjen 25-vjeçarit, e cila i mbaron më 2023, por ai ka kërkuar pagë të lartë vjetore prej 16 milionë eurove. Klubi bavarez nuk e ka ndërmend t'ia plotësojë atij këtë kërkesë, prandaj është i gatshëm ta shesë. Francezi do të shitet hiç më larg se në janar, nëse Bayerni e pranon ndonjë ofertë të kënaqshme për të. Coman ka vuajtur nga lëndime të ndryshme gjatë kohës së tij në "Allianz Arena" dhe i ka bërë vetëm shtatë paraqitje për skuadrën e Julian Nagelsmannit deri tani këtë sezon.

## Diazi shërohet nga Covidi

AC Milan ka njoftuar se Brahim Diaz është shëruar nga Covid-19. Mefshuhori rezultoi pozitiv me Covid më 15 tetor, por tani është rikuperuar, teksa tani do t'i lejohet të stërvitet me ekipin. "AC Milan njofton se Brahim Diaz ka

rezultuar negativ", thuhet në një deklaratë të klubit. Kuqezinjtë presin Torinon në San Siro sonte, por spanjulli nuk do të jetë i disponueshëm për ndeshjen, shkruan footballitalia. Brahim, 22 vjeç, ka pasur një fillim të

shkëlqyer të sezonit me katër gola dhe dy asistime në nëntë paraqitje në të gjitha garat. Kuqezinjtë janë liderët e Serisë A me pikë të barabarta me Napolin. Mbetet për t'u parë nëse Brahim do të ftohet kur

kuqezinjtë të udhëtojnë në Romë të dielën për t'u përballur me Romën e Jose Mourinhos. Theo Hernandez, gjithashtu, u shërua nga Covid dy ditë më parë. Francezi është në dispozicion kundër Torinos, por

do të startojë sonte nga stoli. Brahim u kthye në Milan në një huazim dyvjeçar nga Real Madridi në verë. Kuqezinjtë kanë një opsion për ta bërë lëvizjen e tij të përhershme për 22 milionë euro.



Bilanci i gjendjes me: 30.09.2021

Euro '000

	Tremujori paraprak (30.06.2021)	Tremujori vijues (30.09.2021)
<b>Pasuritë</b>		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	17,491	13,176
Kërkesat ndaj bankave	5,567	8,413
Bonot e thesarit	1,356	1,351
Investimet në letra me vlerë	-	-
Kreditë dhe paradhënie ndaj klientëve	79,771	88,928
Patundshmëritë dhe pajisjet	2,199	2,088
Pasuritë e paprekshme	111	109
Pasuritë tatimore të shtyra	-	-
Pasuritë tjera	761	796
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>107,256</b>	<b>114,862</b>
<b>Detyrimet</b>		
Depozitat e klientëve	80,121	83,100
Detyrimet ndaj bankave	7,598	11,098
Fondet tjera të huazuara	5,448	6,491
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	1,954	1,917
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>95,121</b>	<b>102,605</b>
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>		
Kapitali aksionar	10,000	10,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	2,318	2,318
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	(184)	(61)
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>	<b>12,134</b>	<b>12,257</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve</b>	<b>107,256</b>	<b>114,862</b>

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.09.2021

Euro '000

	Tremujori paraprak (30.06.2021)	Tremujori vijues (30.09.2021)
Të hyrat nga interesi	1,935	3,101
Shpenzimet e interesit	(837)	(1,267)
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>	<b>1,099</b>	<b>1,834</b>
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	118	176
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	(8)	(22)
<b>Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet</b>	<b>110</b>	<b>153</b>
Neto të hyrat nga tregtimi	21	20
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	10	10
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	(970)	(1,435)
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>(940)</b>	<b>(1,405)</b>
Provizionet për humbjet nga kreditë	(473)	(649)
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<b>(204)</b>	<b>(67)</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim/ tatimi i shtyrë	20	5
<b>Fitimi/(humbja) neto</b>	<b>(184)</b>	<b>(61)</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>(184)</b>	<b>(61)</b>

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO

## SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Environmental and Social Performance Services
Procurement Ref. Number	IC/ MFK/2021/026
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Individual Consultant- Services
Employer	Millennium Foundation Kosovo (MFK)
Publication Date	26 October 2021
Submission Deadline	04 November 2021; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo (MFK), has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The MFK, the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for selection of an individual consultant for Environmental and Social Performance Services.

MFK is currently seeking a one (1) full-time Environmental and Social Performance (ESP) Individual Consultant to provide services towards effective implementation of the Threshold Program comprising of Reliable Energy Landscape Project and Transparent and Accountable Governance Project and several project related activities such as: Household Investments in Energy Efficiency (PIEE), District Heating Metering (DHM), Woman in Energy (WE), Independent Power Producer (IPP), Air Quality Information Management, and Dig Data Challenge on Air Quality (Dig Data).

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MFK, money is already available to the MFK and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This LOI is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website ([www.mcc.gov/ppg](http://www.mcc.gov/ppg)). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of Letter for Invitation (LOI) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/selection-of-an-individual-consultant-for-environmental-and-social-performance-services-ic-mfk-2021-026>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org), giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **04 November 2021; 14:00 pm (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

<b>The address referred to above is:</b>	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
<b>Attn:</b>	Arton Çitaku MFK Procurement Manager
<b>Tel:</b>	00 383 38 752 110
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:procurement@millenniumkosovo.org">procurement@millenniumkosovo.org</a>
<b>Website:</b>	<a href="http://www.millenniumkosovo.org">www.millenniumkosovo.org</a>



## K O N K U R S

- Të shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
- **Pozita e punës: Zyrtar/e i/e Burimeve Njerëzore**
- **Numri i pozitave:** 1 (një)
- **Kohëzgjatja e punës:** 1 vit me mundësi vazhdimi
- **Paga bruto:** Në bazë të Rregullores për Paga.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për punët organizative të burimeve njerëzore (BNJ), përgatitë procedurat për rekrutim të personelit gjatë vitit kalendarik në harmoni me kërkesat e menaxhmentit të TU.
- Përgatitë procesin e intervistimit të kandidatëve, listën e kandidatëve për intervista, listën për testim dhe listën e shpalljes për kandidat të përzgjedhur.
- Mbanë përgjegjësi për dosjet e punëtorëve si dhe mban ne konfidencialitet të plote dosjet e secilit të punësuar në TU.
- Pranon fletëparaqitjet disiplinore dhe i dërgon tek komisioni disiplinor, ndihmon komisionin disiplinor në përgatitjen e rasteve dhe nxjerrjen e provave, njëherit shërben edhe si sekretar teknik i komisionit.
- Përgatitë dhe procedon procedura, duke u bazuar në rregullat e brendshëm, ligjeve përgatitë procedurat për masë disiplinore për të gjithë punëtorët e TU që shkelin rregullat e punës sipas rregullave, procedurave dhe ligjeve që janë në fuqi.
- Përpunon të gjitha të dhënat statistikore që janë relevante me administrim të personelit në nivel të TU.
- Përgatitë programin e trajnimeve për stafin e TU, përgatitë plane, mujor dhe vjetor për burimet njerëzore.
- Punon në bazë të procedurave të administrimit të personelit, propozon hartimin e procedurave për administrimin e personelit,
- I përgatit kontratat e punës për të gjithë punëtorët e TU, i përgatit vendimet për pushim vjetor, i përgatit kartelat e identifikimit për punëtorët e TU, në bashkëpunim me Sekretarin e ndërmarrjes.
- Azhuron punët në dosjet e punëtorëve dhe punët në modulin e Burimeve Njerëzore, mbanë evidenca për pushimet e punëtorëve të përcaktuar sipas Ligjit të Punës në fuqi.
- Ndihmon në përgatitjen teknike të trajnimeve konform rregullores së brendshme të trajnimeve për stafin e TU.
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës si dhe detyrave të ngarkuara nga Sekretari.

### 1. Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në Juridik, Administratë Publike apo Shkenca Sociale;
- Përvojë pune në Burime Njerëzore së paku 1 vit të dëshmuar edhe përmes Trust-it.
- Njohuri të mira rreth Ligjit të Punës, identifikimin e nevojave për trajnime dhe organizimin e tyre, organizimi i stafit, identifikimi i nevojave të stafit që lidhen me natyrën e punës, përpilimi i shkresave dhe aftësi analitike etj..
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft Office (Word, Excel, Outlook).
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

### 2. Dokumentacioni i kërkuar:

-Kandidati/ja, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com):

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar edhe përmes Trust-it.
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

### Informata të përgjithshme:

-- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data **27.10.2021** dhe përfundon më datë **10.11.2021** në ora 24:00

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "HOME 1" SH.P.K. me pronar Shaban Hashani Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 810728272, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "HOME 1" D.O.O. Shaban Hashani Obiliq, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues: 810728272 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "HOME 1" L.L.C. Shaban Hashani Obiliq, has come to the decision to quit its business: nr. Unik Identifikues: 810728272 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "FRIENDS-L" SH.P.K. me pronar Lulzim Hashani Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb: 810063751 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "FRIENDS-L" D.O.O. Lulzim Hashani Obiliq, donelo odluku o prestani rada sa nrb: 810063751, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "FRIENDS-L" L.L.C. Lulzim Hashani Obiliq, has come to the decision to quit its business: 810063751 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT**

Në bazë të nenit 66 dhe 67 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullores nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr. 03/2017 për procedurat e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese neni 15, paragrafi 3, njoftohen të gjithë aplikantët, për zgjatjen e afatit të konkursit të datës 11 tetor 2021, edhe për shtatë (7) ditë kalendrike, i cili është publikuar në gazetën ditore "Koha Ditore" dhe "Epoka e Re" dhe në Ueb faqen e KQZ-së, për pozitën:

1. **KQZ- 32/2021 Zyrtar i Lartë i Listës Votuese**
2. **KQZ-33/2021 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë**
3. **KQZ -34/2021 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan**

Përmbajtja e konkursit mbetet e njëjtë me konkursin e shpallur në datën e lartëshenuar. Konkursi mbetet i hapur shtatë (7) ditë kalendrike nga dita e publikimit, përkatësisht deri me datën 02 nëntor 2021.

Kërkesat e dërguara pas kalimit të afatit për aplikim dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit 038 200 23 557.

**OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU ROKA KONKURSA**

Na osnovu člana 66. i 67. Zakona br. 03 / L-073, o opštim izborima u Republici Kosovo, Uredbe br. 01/2017 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Sekretarijatu Centralne izborne komisije, Uredbe br. 03/2017 o postupcima prijema, imenovanja i probnog rada član 15. stav 3. obaveštavaju se svi podnosioci prijava, za produženje konkursnog roka do 11. oktobra 2021. godine, za još sedam (7) kalendarskih dana, koji je objavljen u dnevnom novinama „Koha Ditore“ i „Epoka e Re“ i na Web stranici CIK-a, za poziciju:

1. **CIK- 32/2021 Viši Službenik Biračkog Spiska**
2. **CIK-33/2021 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Mamuši**
3. **CIK -34/2021 Viši Službenik Opštinske Izborne Komisije u Lipljan**

Sadržaj konkursa ostaje isti kao u konkursu objavljenim na gore navedeni datum. Konkurs ostaje otvoren sedam (7) kalendarskih dana od dana objavljivanja, odnosno do 2. novembra 2021. godine.

Zahtevi dostavljeni nakon isteka roka za prijavu i nepotpuni zahtevi neće biti razmotreni. Za dodatne informacije, molimo vas pozovite broj telefona 038 200 23 557.

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lumë's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

**PRISHTINË**

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Fjolla Bajraktari nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl..XII të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".
- Hyre Miftari nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e kl. I, II, III, IV të SH.M. të Mjekësisë "Hysni Zajmi".
- D.PT "Selaci" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër 330438590.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

